




REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E MIRËQENIES
SOCIALE DHE RINISË

Ministrja Xhaçka, prezanton për herë të parë regjistrin e integruar elektronik kombëtar

2017-05-18 16:02:00



Ministrja e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, znj. Olta Xhaçka, prezantoi sot për herë të parë, Regjistrin e Integruar Elektronik Kombëtar, për qytetarët që kanë të drejtë të kenë akses në shërbime sociale, në ndihmëekonomike dhe në pagesat e aftësisë së kufizuar. Ministrja e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, znj. Olta Xhaçka, prezantoi sot për herë të parë, Regjistrin e Integruar Elektronik Kombëtar, për qytetarët që kanë të drejtë të kenë akses në shërbime sociale, në ndihmëekonomike dhe në pagesat e aftësisë së kufizuar.

Fjala e plotë e Ministres Xhaçka:

Duke Ju uruar mirë se ardhjen të gjithëve, më lejoni t'ju them se **çdo individ në nevojë përfaqëson për Qeverinë tonë një sfidë sociale, një përgjegjësi morale, dhe një jetë që mund të jetohej më mirë.**

Ne duam që shërbimet të kenë në fokus fëmijët, gratë, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, familjet në vështirësi. Këto grupe kanë nevoja komplekse, që kërkojnë ndërhyrje të shumëfishta dhe më duhet të them se ofrimi i shërbimeve të përshtatshme dhe të larmishme është ende një sfidë.

Shpesh qytetarët, nuk e kanë informacionin që është vital për jetët e tyre – informacionin që lidhet me të drejtat e tyre bazike, me shërbimet publike, shëndetin, arsimin dhe mundësitë e punësimit.

Mungesa e informacionit apo mekanizmave për ta aksesuar atë, largon individët ngashërbimet.

Megjithatë, **sot ne po hedhim poshtë një pengesë të madhe, duke digjitalizuar çdo të dhënë për grupet në nevojë që deri dje ishin në letër ose s'ishin fare.** Jam shumë kënaqur, që **sot bëjmë të dukshme atë që ka qenë e padukshme deri dje. Prezantojmë për herë të parë Regjistrin e Integruar Elektronik Kombëtar, me qëllim lehtësimin e jetës të çdo qytetari,** i cili ka të drejtë të ketë akses në shërbime sociale, në ndihmë ekonomike, në pagesat e aftësisë së kufizuar apo në mundësitë për punësim ose formim profesional.

Të dhënat dhe vlerësimet e situatës të 80.000 grave, që sot janë pjesë e skemës së ndihmës ekonomike, 154.000 individëve me aftësi të kufizuara, rreth 4000 fëmijëve, prindërve, të moshuarve dhe shumë përfituesve

të tjerë të shërbimeve, që ofrojnë organizatat jo-fitimprurëse, janë sot pjesë e një sistemi elektronik.

Kështu, **lehtësojmë mënyrën që i duhet një individ për të aplikuar, i japim mundësi të ketë akses në të gjitha shërbimet për të cilat ka të drejtë të marrë, dhe shkurtojmë kohën e marrjes së përgjigjes. Por mbi të gjitha sigurojmë një rrugë të sigurtë, drejt riintegrit dhe përfshirjes së tyre në shoqëri për një jetë më të mirë dhe të jetuar me dinjitet.**

Sot, një personi me aftësi të kufizuara, nuk do ti duhet më të rropatet nga një spital në tjetrin për të marrë vërtetime dhe epikriza. Sot, sistemi elektronik mundëson asistimin e tyre vetëm

nga mjeku apo punonjësi social për të plotësuar vetëm një formular, duke evituar kështu kalvarin e vajtjes nga një institucion në tjetrin.

Po ju ilustrim një shembull konkret. Një person me aftësi të kufizuara, përpara krijimit të regjistrit elektronik, për të marrë përfitimin nga sistemi i vlerësimit të aftësisë të kufizuar, iduhej të sorrollejt në mjekë, mund ti kërkohej shtrim në spital, i nevojiteshin vërtetime të ndryshme për paftësinë e tij, i duhej vërtetimi i gjendjes sociale ekonomike, vërtetime nga komisioni mjeko-ligjor etj. E gjitha kjo, për t'ju drejtuar një komisioni tërësisht mjekësor, për të marrë vetëm një diagnozë mjeksore.

Pra siç e shikoni një sërë vërtetimesh dhe ece jakesh, të cilat kërkojnë të paktën rreth 1 muaj kohë. Mbi të gjitha, të gjitha këto ece jake, të jepnin vetëm një diagnozë dhe asnjë rekomandim për shërbim që i nevojitet riintegrit të një personi me aftësi të kufizuara, në jetën shoqërore. Përveç kësaj komisioni mjekësor, ka një rradhë të gjatë për të vlerësuar një person me aftësi të kufizuara edhe për shkak të numrit të madh të rasteve që diagnostikohen çdo ditë. Theksoj këtu, që ky komision përbëhet vetëm nga mjekë dhe është jashtë sistemit të shërbimeve sociale duke afektuar edhe kosto, për ne pasi ata duke mos qenë punonjës brenda sistemit paguhen së jashtmi.

Kthehemi në ditën e sotme e në vazhdim. Një person me aftësi të kufizuara duhet të plotësojë vetëm një epikrizë tek mjeku i familjes dhe mjeku specialist dhe vetëm me një kartë identiteti i drejtohet komisionit të ri të vlerësimit të aftësisë të kufizuar, pranë shërbimit social shtetëror. Ky komision, ka nëpërmberjen e tij, jo vetëm mjekë, por edhe punonjës socialë dhe psikologë, pra një ekip multidisiplinar, i cili vlerëson jo vetëm anën mjeksore të këtij individ por dhe nevojat funksionale të tij. [D.m.th](#) nevojat për punësim, për shërbime sociale të specializuara apo arsimim përfshien të gjitha në këtë vlerësim.

Ky ekip multidisiplinar, është pjesë e brendshme e administratës tonë dhe vlerëson sipas një sistemi bashkëkohor të miratuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (ICF), qënë fakt i përgjigjet dhe standardeve bashkëkohore evropiane.

Përfitimet në të ardhmen nga kjo gjë, janë që çdo individ që do vlerësohet nëpërmjet këtij sistemi, e para nuk harxhon më kohë dhe e dyta hyn në një sistem që i mundëson plotësimin e nevojave për shërbimet që duhet të marrë për integrimin e tij. Një fëmijë me aftësi të kufizuara që merr këtë vlerësim, do të garantohet që do shkojë në shkollë, pasi ky sistem komunikon me të gjitha institucionet përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve.

Pra të dashur miq, po bëhemi një sistem kompakt, për tu siguruar që ai që ka nevojë, të marrë maksimumin. Njëkohësisht për herë të parë në këtë sallë, po krijohet një arkivë digjitale për 154 mijë individë me aftësi të kufizuara, e cila përmban çdo dokument me historinë e paftësisë, për të gjithë ata që përfitojnë nga pagesat e aftësisë së kufizuar.

Nëpërmjet Regjistrit elektronik, çdo e dhënë apo vlerësim i situatës që është hedhur në sistem, kontrollohet në kohë reale nga përdoruesit e regjistrit, që janë inspektorët e zyrave rajonale, administratorët socialë, mjekët dhe punonjësit socialë.

Mbrapa këtij sistemi qendron një armatë e tërë profesionistësh, të cilët me profesionalizëm mirëpresin qytetarët dhe do të lehtësojnë rrugëtimin e tyre drejt një jete më të mirë. Çdo administrator i këtij sistemi, ka mundësi që të identifikojë në kohë reale:

- çdo të dhënë për familjen nëse është në skemën e ndihmës ekonomike apo jo;
- ka mundësi të verifikojë individin, nëse është me aftësi të kufizuara apo nëse është përfitues i shërbimeve sociale, duke evituar marrjen e një sërë vërtetimesh për gjendjen familjare të tyre.

Njëkohësisht integrimi online i të dhënave, lehtëson shkëmbimin e informacionit dhe dijeve midis profesionistëve.

Ky regjistër na jep mundësinë të hedhim një hap më shpejt

drejt konsolidimit të një sistemi të integruar shërbimesh për individin, gjë që do të mundësonte shërbim cilësor pranë familjeve, individëve në nevojë, me një ndalesë të vetme. Shërbimet e integruara janë një mundësi unike për t'ju përgjigjur situatave komplekse të individëve në kohë të shkurtër dhe me cilësi.

Unë e di që ngritja e shërbimeve ka shumë sfida, ndaj dhe nuk presim të jemi perfekt që në fillim. Kemi mësuar nga eksperiencia, do vazhdojmë ta bëjmë dhe do marrim ekspertizën më të mirë për të realizuar çdo gjë që themi. **E rëndësishme është të mos humbim asnjëherë fokusin tonë, individin.**

Çdo veprim që ndërmarrim, dhe që bëhet në interesin më të lartë të fëmijëve, familjeve dhe individëve në nevojë, do na afrojnë më shumë me qytetarin dhe do na shpërblejë të gjithëve më shumë në të ardhmen.

Synojmë një sistem shërbimesh ku mësojmë nga komuniteti, nga familjet dhe fëmijët, të moshuarit dhe gratë që marrin shërbime, kështu i fuqizojmë ata që të jenë pjesë e shërbimit që marrin dhe të bëjnë zgjedhjet e duhura.

Së fundmi, por jo më pak e rëndësishme dëshiroj të falenderoj partnerët tanë strategjikë që mundësuan jetësimin e regjistrit elektronik, Bankën Botërore dhe Unicef, si dhe AKSHI-n për kreativitetin në krijimin e një platforme efikase të regjistrit.

Faleminderit!